



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROCESVERBAL**

**Nr. 10, datë 16.12.2024**

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit  
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:13

Data e mbajtjes së mbledhjes : 16.12.2024

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

**Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës:** Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako, si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

**Ani Dyrmishi:** Përshëndetje të gjithëve.

Të nderuar Këshilltarë ! E nderuar Kryetare ! Të nderuar të pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës së Këshillit Bashkiak Durrës.

Siç jeni vënë në dijeni nëpërmjet email-it keni marrë gjithë materialet.

Ftoj sekretaren të bëj prezencën.

**Dorina Milja:** Përshëndetje!

Fillojmë me prezencën.

Ardian Muka.....deri tek.... Florian Tahiri..... 41 Këshilltarë në sallë .

**V.O...** Hyn me vonesë gjatë mbledhjes këshilltarja Ana Dhamo dhe Elizabeta Mataj. Gjithsej gjatë mbledhjes 43 këshilltarë në sallë.

**Ani Dyrmishi:** Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

**Flutura Kasa :** Kryetar ?

**Ani Dyrmishi:** Një sekond Flutura, të lutem se ta jap unë fjalën.

Për procedurë?

Ça kishe për procedurë?

**Flutura Kasa :** Jo dua ta them para rendit të ditës.

**Ani Dyrmishi:** Thuaje.

**Flutura Kasa :** Kisha një ankesë që është bërë shumë problematike. E kam bërë individualisht dhe me mesazhe për disa. Problem është Komisioni i Strehimit për pjesmarrje, është shumë problem mungesat e këshilltarëve. Këshilltarët nëse i quajnë tepër për të ardhur në mbledhje komisionesh, janë të lirë me dhënë dorëheqjen se lista është me 52 veta. Të gjithë zëvendësohen dhe asnjë nuk është i pazëvendësueshëm. Momenti që unë kam bërë një fushatë që jam lodh si gjithë të tjerët që janë këtu, unë do respektoj veten time dhe ato njerëzit që janë jashtë. Është shumë problem Komisioni i Strehimit dhe nuk mund të ma mohojë dot asnjë njeri, se i kam çu mesazhe. Prandaj të lutem o mblidhi Kryetarët e Grupeve dhe diskutoje seriozisht këtë punë ose atëherë po bëj mungesa dhe unë dhe e mbledhim mendjen.

**Ani Dyrmishi:** Do marrim masa për ato. Në bazë të ligjit dhe rregullores do të marrim masa dhe do ta pasqyrojmë në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak.

Faleminderit për shqetësimin.

Atëherë sot për shqyrtim e miratim kemi 7 pika.

Unë po kaloj në leximin e tyre.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN NËNTOR 2024
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DHËNIEN E MIRATIMIT KRYETARIT TË BASHKISË PËR NËNSHKRIMIN E KONVENTËS SË KRYETARËVE TË BASHKIVE – EVROPË PËR KLIMËN DHE ENERGJINË

Pika 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË 4,133,471 LEKË, PËR FAMILJET, QË KANË PËSUAR DËME SI PASOJË E RËNIES SË ZJARRIT NË BANESAT E TYRE
Pika 4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË PROGRAMIT TË KREDISË SË LEHTËSUAR PËR STREHIM ME 3% INTERES
Pika 5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SHITESË EMËRORE TË FAMILJEVE QË PËRMBUSHIN KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BONUSIT TË STREHIMIT QË DO TË AKORDOHET NGA MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT NË FAVOR TË BASHKISË DURRËS PËR SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR VITIN 2024
Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E VLERËS PARAPRAKE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA INVESTIMI QË DO TË REALIZOHET NË ZBATIM TË MARRËVESHJES NR. 7773/1 PROT., DATË 02.10.2023, LIDHUR NDËRMJET AADF, MINISTRISË SË KULTURËS DHE BASHKISË DURRËS.
Pika 7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit të propozuar nga kryetari i këshillit dhe miratuar nga Konferenca e Kryetarëve	PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS SË KËSHILLIT TË BASHKISË DURRËS PËR PERIUdhËN JANAR – DHJETOR 2025
*****	DISKUTIME DHE PYETJE NGA KOMUNITETI

**Ani Dyrmishi:** Në lidhje me rendin e ditës kemi ndonjë .....?

Po zoti Muka.

**Ardian Muka** Me thënë të drejtën sot jemi me 16 dhjetor dhe nuk e di nga ana e bashkisë është neglizhencë që akoma nuk na është sjellë projektbuxheti. Nuk arrij ta kuptoj, se si kjo bashki do të eci për vitin tjetër, kur neve po mbyllim vitin dhe akoma nuk është paraqitur projektbuxheti për

trajtim për miratim nga ana e këshilltarëve. Do të doja një përgjigje nga ana e drejtuesve të bashkisë: Kur ka ndërmend ta sjellin dhe motivin që pse se kanë sjellë deri tani? Faleminderit.

**Ani Dyrmishi:** Për ndërhyrje për procedurë zoti Ardian Muka, kjo s'ka lidhje me rendin e ditës, gjithsesi kryetarja nëqoftëse ka dëshirë mund të flasi, por kjo është jashtë rendit të ditës, që kështu nuk besoj që është ...

**Emiriana Sako:** Afati është deri në dhjetor deri në fund të muajit kështu që në mbledhjen e radhës do të silllet propozimi për miratim.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Problem tjetër me rendin e ditës ka?

Atëhere nuk ka, kalojmë në votim

Kush është pro miratimit të rendit të dirës?

(...bëhen biseda se po votohet elektronikisht dhe ka probleme teknike....)

Atëherë 38 pro, 4 kanë ngel pa votuar. Atëherë miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në **pikën e 1-rë**. I japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit zonjës Xhiliola Doçi.

**Xhiliola Doçi :** Faleminderit kryetar.

Komisioni jonë u mbledh dhe propozoi që pika 1 t'i kalojë në Këshill Bashkiak për votim.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit zonja Doçi.

Komente përsa i përket pikës 1, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Unë propozoj të kalojmë në votim me kartona, derisa të stabilizojmë pak problemet teknike se.....

Kush është pro miratimit të pikës 1 rendit të ditës?

Kundra? ....

Abstenim? ....Nuk ka.

Atëherë me 43 pro miratohet pika 1 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 2**. I japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zotit Rakipi.

**Dritan Rakipi:** Komisioni i Rregullores dhe Çështjeve Juridike u mbledh dhe vendosi që për pikën 2 ta kalojë në votim .

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

I japim fjalën Komisionit të Mjedisit dhe Tratimit të Mbetjeve zonja Meçi.

**Klementina Meçi :** Atëhere Komisioni i Mjedisit dhe Trajtimit të Mbetjeve mori në shqyrtim projektpropozimin e sjellë nga bashkia sipas së cilës kërkohet miratimi në parim i Kryetarit të Bashkisë për nënshkrimin e Konventës së Kryetarëve të bashkisë për në Europë, për kilmën dhe

energjinë. Proces, i cili do t'i hapi rrugë hartimit të planit të veprimit për energjinë e qëndrueshme dhe luftimin e ndryshimeve klimaterike. Me shumicë votash komisioni vendosi që të propozoi kalimin në Këshill Bashkiak.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit zonja Meçi.

Komente përsa i përket pikës 2, kemi nga ana e këshilltarëve ?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra? .....

Abstenim?.....

Nuk ka .

Atëhere 43 vota pro miratohet pika 2 e rendit të ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 3**. I japim fjalën Komisionit të Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë zonjës Zhuljeta Ngota.

**Zhuljeta Ngota:** Përshëndetje të gjithëve!

Desha të prek disa pika që ndoshta nuk kanë lidhje sot me tematikat, por që kanë të bëjnë me aktualitetin .

**Dorina Milja:** E ke në fund atë. Tani je për pikën që kalove në komision nëse jeni dakord apo jo.

**Ani Dyrmishi:** Shprehu për pjesën e komisionit. Pastaj në fund atë.

**Zhuljeta Nogota:** Aaa ok.

Komisioni i Emergjencave Civile është dakort që të kalojë në miratim.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Komente në lidhje me pikën 3?

Atëhere komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra? .....

Abstenim? .....

Nuk ka .

Atëhere me 43 vota pro miratohet.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 4**. I japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike zonjës Feshti.

**Marsida Feshti:** Përshëndetje!

Komisioni miratoi për ta kaluar në votim në mbledhje.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Në lidhje me pikën 4 kemi ndonjë koment?

Po zoti Muka.

**Ardian Muka** Kërkoj nga ana e Komisionit se kush mund të përgjigjet: Kush janë kriteret për marrjen e kësaj kredie? Pastaj kam interpretim për një ose 2 raste që kam kapur.

**Diana Mandia** (*specialiste Sektori Strehimit*): Përshëndetje.

Kriteret kryesore për marrjen e kredisë duhet që familja të jetë e pastrehë, të mos ketë pronë, të mos ketë legalizim, të ketë të ardhura të përcaktuara në bazë të tabelës, që na ka adhur nga ministria dhe të plotësojë kushtet sipas Ligjit 22/2018 të strehimit. Aplikimet bëhen online nga sistemi dhe afishimet janë po online.

**Ardian Muka:** Faleminderit!

**Ani Dyrmishi:** Atëhere ndonjë koment tjetër? Nuk ka.

Atëhere kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra? ...Nuk ka

Abstenim? ...Nuk ka

Atëhere miratohet edhe pika 4 e rendit të ditës me 43 vota pro.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 5**. I japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike zonjës Feshti.

**Marsida Feshti:** Përshëndetje prap.

Komisioni është dakort të kalojë për votim në mbledhje.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 5?

**Ardian Muka:** Të njëjtën gjë dhe në këtë rast për çfarë diskutohet, diskutohet për banorët, të cilët janë të prekur nga tërmeti?

**Emiriana Sako:** Jo.

**Ardian Muka:** Apo nuk ka lidhje me tërmetin, pra janë banorët të cilët nuk kanë mundësi ekonomike.

**Emiriana Sako:** Po, kjo është një nga programet e strehimit që na mundëson ligji në fuqi, pra njëra nga pikat është kredia e butë ku ne sot miratojmë 794 familje, ndërsa familjet përfituese të bonusit të qerasë, marim 50 % të bonusit. Pas miratimit nga Këshilli Bashkiak, dërgohet procedura në ministri dhe janë familje të cilat janë në ndihmë ekonomike, janë nëna të vetme. Pra të gjitha ato kritere që ka ligji i strehimit, për shtresat në nevojë.

**Ardian Muka:** Jepet 50 %-in të vlerës së qerasë?

**Emiriana Sako:** 50%-in po, të vlerës së qerasë dhe në këtë rast kemi 94 familje në këtë listë.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Koment tjetër?

Nuk ka.

Kalojmë në votim, kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim?.....Nuk ka.

Atëhere me 43 vota pro miratohet.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 6** i jepet fjala Komisionit të Rregullores, Çështjeve juridike zotit Rakipi.

**Ardian Muka** Unë kisha diçka për procedure.

**Ani Dyrmishi:** T'i mbarojmë Komisionet përpara dhe pastaj.....

**Ardian Muka :** Ligji është që kur ka konflikt interesi, kam deklaruar .....

**Ani Dyrmishi:** Po, po.

**Ardian Muka:** Kam deklaruar që kam konflikt interesi duke pasur një banesë në zonën në të cilën merret në trajtim. Por ajo banesë faktikisht nuk preket nga ajo çfarë neve sot do të diskutojmë. Domethënë nuk është as pjesë e shpronësimit, as tokë, as banesë, kështu që më këtë rast do të kërkoj një interpretim nga ana juaj, jo meqenëse duket sikur po loz, unë e kam deklaruar gjënë, por mund të rrij apo mund të mos rrij meqenëse ashtu, thashë unë nuk është se ndikoj ke vendimi për marrjen...

**Emiriana Sako:** Mund të na e thuash çfarë bëhet me këtë banesën?

**Ardian Muka :** Urdhëro?

**Emiriana Sako:** Çfarë bëhet me këtë banesën?

**Ardian Muka :** Banesa që kam?

**Emiriana Sako:** Po, çfarë thotë projekti për këtë banesën?

**Ardian Muka:** Në këtë rast ajo është pjesë e rikonstruksionit besoj të përgjithshëm, por nuk hyn tek pjesa e shpronësimeve që ne po diskutojmë sot.

**Emiriana Sako:** Jo, thjesht se nuk e dija në detaj.

**Ardian Muka:** Pra as nuk shëmbet dhe e merr shteti dhe t'jep lekët dhe as nuk kam tokë që nuk...

**Emiriana Sako:** Rikonstruktohet në këtë rast.

**Ardian Muka:** Urdhëro?

**Emiriana Sako:** Restaurohet, rikonstruktohet.

**Ardian Muka :** Restaurohet, thjesht është tek pjesa e restaurimit .

**Ani Dyrmishi:** Si procedurë, në kuptimin e ligjit unë mendoj që deklarimi i konfliktit të interesit është përgjegjësi e jotja individuale dhe përgjegjësisë e merr ti personalisht lidhur me atë deklaram që bën. Aktualisht në këto kushte nuk mund të verifikojmë që ajo banesë që ti mendon që është apo s'është konflikt ineresi.

**Ardian Muka** Nuk është konflikt interesi pastaj .....

**Ani Dyrmishi:** Është ana ligjore e jotja. Është përgjegjësi e jotja nëse do të heqësh dorë.

**Ardian Muka:** Nuk është, nuk është për mua, nuk është, megjithatë tashi unë e kam deklaruar, por e tërheq.

**Ani Dyrmishi:** Deklarata është përgjegjësi e jotja individuale nuk ka lidhje. Unë mendoj që, jo si kryetar këshilli, por si jurist përse kohë e ke deklaruar konfliktin e interesit duhet t'i qëndrosh në rast edhe se ke, edhe se s'ke, pastaj se si e mendon ti, është çështja jote personale. Ti e ke gjykuar përpara dhe e ke marrë këtë vendim.

**Ardian Muka:** Nuk kisha rregulloren me thënë të drejtën, nuk kisha rregulloren...

**Ani Dyrmishi:** Është çështje individuale, ta sqarova.

**Ardian Muka:** Ok, faleminderit.

**Jonuz Myshketa:** Mundem?

**Ani Dyrmishi:** Zoti Myshketa, po.

**Jonuz Myshketa:** Si rasti i zotit Ardian Muka unë kam, është një truall i famijes sime, i cili preket nga shpronësimi dhe deklaroj që kam konflikt të drejtëpërdrejtë interesi në lidhje me çfarë



trajtohet këtu përtej atij rasti dhe verifikohet. Është në emrin e timgjyshit pjesa që shpronësohet, kështu që në respekt të kësaj më duhet të largohem.

**Ani Dyrmishi:** Atëhere duhet të largoheni nga salla zoti Myshketa .

**Dritan Rakipi:** Vetëm për votim?

**Ani Dyrmishi:** As në diskutim, as në votim, jo është çështje rregullore nuk është çështje që e vendosim ne, ashtu e ka të përcaktuar rregullorja. Në rast se je në konflikt interesi duhet të largohesh dhe nga diskutimi dhe nga votimi, është çështje rregullore.

**Dorina Milja:** Vetëm për këtë çështje jo për të tjerat, vetëm për këtë pikë.

**Ani Dyrmishi:** Atëhere vazhdojmë i jepet fjala Komisionit të Rregullores Çështjeve Juridike, zoti Rakipi.

**Dritan Rakipi:** U mbledh Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike dhe me shumicë të votave të anëtarëve të komisionit u vendos që kjo pikë të kalojë për votim në Këshill.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit zoti Rakipi.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, zonja Mamo.

**Jonada Mamo:** Faleminderit kryetar.

Edhe komisioni jonë ra dakort ta kalojë për miratim në Këshill, faleminderit.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit zonja Mamo.

Komisioni i Pronave Publike Transportit Trafikut Rrugor zoti Markola.

**Hekuran Markola:** Faleminderit kryetar.

Atëhere Komisioni i Pronave u mbledh, pati një debat realisht të shëndoshë e quaj për vlerën e çmimit. Mendoj që është bërë më e mira e mundshme duke parë që është marrë në konsideratë çmimi mesatar i tre muajve të fundit nga ASHK-ja, që do të thotë është vlera reale e tregut pavarësisht problemeve që një pjesë pretendonin që kjo zonë ka një çmim tregu më të lartë sesa ishin në dokumenta, por mendoj që në këtë rast bashkia ka bërë më të mirën e mundshme për një çmim më të lartë, sa më të lartë të mundur, për shpronësimin e këtyre pronave. Komisioni e kaloj për votim me shumicë votash në Këshillin Bashkiak. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit zoti Markola.

Komente në lidhje me këtë pikë?

Atëherë zoti Ardian Muka, pastaj zonja Devolli.

**Ardian Muka:** Atëhere do ta filloja nga ana formale meqenëse edhe në Komisione e ngritëm këtë problem. Në kthim përgjigje që ASHK-ja ka sjellë, ndaj komenteve që ka kërkuar për interpretim Bashkia e Durrësit, ka një gabim besoj numerik mirëpo që është goxha ndikues në ato çfarë do të kenë vlerat kur flet për pjesën e shpronësimeve. Përsa i takon njësisive tregtare për zonën 8514 çmimi që ato referojnë në përgjigjen e tyre është 12836 lekë, besoj duhet të jetë një lapsus, por edhe në relacionin tuaj është përcjellur po e njëjta vlerë, këtu me siguri mungon një zero sepse nëqoftëse në 8512, zonë kadastrale pra 8512, që është ngjitur me rrugën është 93364, nuk ka mundësi që në zonën 8514 të jetë 12863, është më lirë se çmimi i truallit vetë që është 14743, besoj që duhet marrë në konsideratë kjo, se nëqoftëse ne miratojmë pastaj do të futen në kalvar edhe bashkia edhe gjithë trajtimi që do t'i bëhet. Pika parë.

Pika 2 po për pjesën formale, në listën që kam lexuar të personave që shpronësohen ka shumë pronar, të cilët kanë ndërruar jetë. Nga ana e relatuesve të bashkisë në Komision u tha që kjo është lista që na ka sjellë ASHK-ja, ndërkohë që nuk besoj, sepse të paktën 3 apo 4 komshi që ne kemi aty di që ato e kanë kryer procedurën si trashëgimtar dhe janë ato trashëgimtarët ligjor të pronës. Çfarë do sillte kjo? Do të jepte problematika pastaj nëqoftëse ne e aprovojmë fondin në emër të atij personi që ka ndërruar jetë, automatikisht trashëgimtarët do të fillojnë me procese gjyqësore dhe të gjitha. Ky moment o do sqarohet një sekond me ASHK-në ose nuk e di të lejmë një periudhë kohore nga ana e bashkisë flas që secili, të shpreh interes kush janë personat të cilët kanë këtë problem.

**Ani Dyrmishi:** Të sqaroj në lidhje me këtë pjesën e dytë, sepse jam i informuar për shkak të profesionit, nuk ka lidhje ajo pjesë nëse ato kanë çelur dëshminë e trashëgimisë dhe janë trashëgimtar të atij personit që trashëgon në këtë rast, i kalon thjesht e drejta e trashëgimisë duke i paraqitur dëshminë e trashëgimisë, nuk ka asgjë tjetër.

**Ardian Muka:** Pra nuk humbin të drejtë?

**Ani Dyrmishi:** Jo absolutisht.

**Ardian Muka:** Ngaqë ma kanë kërkuar banorët, e kanë lexuar emrin e vet, ngaqë ka qenë gjyshi aty...

**Ani Dyrmishi:** Në momentin e çeljes së trashëgimisë që ato e kanë bërë, që sipas jush thua që ato e kanë bërë, thjesht paraqesin dëshminë e trashëgimisë që ato janë trashëgimtarët e personit që ka përfituar të drejtën nga kjo pjesë, nuk ka problem ligjor në kuptimin e gjësë.

**Ardian Muka:** Ok, thashë thjesht që edhe bashkia mos të hyjë në gep, dhe banorët mos të...

**Ani Dyrmishi:** Jo jo nuk ka problem ligjor, në ligj është parashikuar nga Kodi Civil, e gjithë pjesa e trashëgimisë ligjore.

**Ardian Muka:** Në rregull.

**Ani Dyrmishi:** Kështu që nuk ndikon ke kjo pjesë, fare.

**Ardian Muka:** Tani përse i takon pjesës të trajtimit që i është bërë kësaj zone, natyrisht që përgëzoj momentin që edhe Bashkia e Durrësit u bë pjesë e këtyre projekteve të rivitalizimit, vonë po më mirë vonë se kurrë. Besoj që Durrësi për ato objekte, të cilat të përfshihen brenda kësaj zone duhet të kishte qenë qysh në momentet e para, qysh sa u hap demokracia duhet të ishte bërë pjesë e trajtimit, flasim për Amfiteatrin, flasim për shumë objekte të tjera të trashëgimisë tonë kulturore, të cilat ndodhen në këtë zone, që kanë ngeluar të pavalorizuara siç duhet, por thashë më mirë vonë se kurrë. Problematikat që aty shof është që meqenëse në këtë zonë ne po bëjmë një ndërhyrje pothuajse radikale, sepse po shkojmë deri në shembje shtëpish, natyrisht ato shpronësohen, por ato banorë do të shkojnë të spostohen diku tjetër, aty ka shumë rrugica, të cilat janë të zëna nga objekte të jashtëligjshme, të cilat nuk janë as pjesë të legalizimeve dhe as pjesë të procedurave të tjera. Ndërkohë që në projekt ato janë të përfshira të paktën nga pjesa e ngjyrave, sikur ato do bëjnë pjesën e rivitalizimit dhe këto objekte, të cilat janë të jashtëligjshme e theksoj janë të jashtëligjshme, sepse kanë qenë pjesë e procedurave të zënies të rrugëve kryesore anësore po flasim ee, se rruga kryesore është bulevardi, por thashë nga viti 2000 unë jam pjesë e trajtimit të paktën të një rasti, ku banorët kanë kërkuar lirim e rrugës, në këtë rast nuk është marrë as parasysh lirimi i rrrugës, por ajo që është, është që objekt i paligjshëm rivitalizohet .

Kërkesë, problem tjetër që aty shoh ndërkohë që ne flasim që kjo zonë është zona A, zonë e cila është pjesë e këtij projekti rivitalizimi ndërkohë aty janë dhënë dhe jepen leje ndërtimi. E di që nuk është pjesë e bashkisë Durrësit, është KKT-ja që i jep, por të japësh leje ndërtimi për objekte 50 m larg Amfiteatrit, ndërkohë që ne po themi do të shemben të gjitha objektet, të cilat janë në afërsi të murit 20 m të murit rrethues, të murit të parë rrethues po flasim të qytetit, për mu ka diçka që nuk shkon, ka diçka që nuk shkon dhe këtu do të insistoja natyrisht neve nuk jemi institucion që hyn në pjesën e projektimit flas Këshillit Bashkiak, por nga profesioni unë jam i detyruara ta them, dhe natyrisht pa abuzuar fare në pjesën politike, po them që në ato objekte, të cilat janë dhënë këto lloj lejesh unë dyshoj që ka ngjyrim e dhe politike, ku qytetarët e thjeshtë nuk arrijnë të rregullojnë as një çati aty, ndërkohë që atje janë dhënë leje ndërtimi që sot e kësaj dite qytetarët besoj i shohin.

Një nga probemet që ne ngritëm në komision po besoj që ajo u rezauro për fat të keq, për fat të keq them të qytetarëve, bashkëqytetarëve të mi, pjesa informale e gjësë ka mbizotëruar në atë çfarë është pjesa formale, pra bashkia në këtë rast mund të tërhiqet dhe të thotë që neve nuk jemi, sepse i kemi kërkuar një vërtetim ASHK -së, ku ka ardhur që çmimi mesatar tre mujor është ai të cilën ato kanë sjellë, dhe natyrisht nuk po marim si bazë çmimin e Entit të Banesave, i cili do të ishte akoma më poshtë, por marrim si çmim bazë atë që ASHK-ja na ka sjellë. E dimë që sot në atë zonë të gjithë neve bashkë çmimi real i deklaruar dhe e theksoj këtë “çmimi real i deklaruar” është në ato vlera ndoshta pra mund të jetë 700 – 800 euro m<sup>2</sup>, por ajo zonë, që të gjithë neve e dimë që realisht trajtohet me çmime tjera, pra 1500-2000 euro banesë dhe mbi 2000 euro metri çmimi i njërive tregtare. Thashë këtu do të jetë një problem që realisht ato banorë, të cilët i kap ky projekt rivitalizimi i gjithë zonës do të vuajnë pak papërgjegjshmërinë e bashkëqytetarëve të tjerë, të cilët kontratat që kanë bërë. Unë nuk hedh hi dyshimine atë çfarë ASHK-ja ka sjellë, duke pasur parasysh që aty është bërë një lapsus në shkresën që ASHK-ja ka sjellë në faktin që unë ju

deklarova pak më parë, besoj do të ishte them e moralshme t'ju rikërkonte edhe një herë ASHK-së çmimet. Unë di që me vendimin e VKM-së 1052, datës 02.12.2024, kjo zonë është riprekur dhe është riprekur për akoma më poshtë, pra del që deklarimet që janë bërë në tremujorin e fundit, sepse ky tremujor kap vlerën nga gushti deri në tetor i pari, ky i dyti është deri në fund të dhjetorit janë akoma dhe më poshtë, por duke pas parasysh që sensibilizimin dhe sensibilitetin që kjo çështje ka, banorët e kanë këtë problem thonë ok, po shkëputemi nga kjo zonë po japim një benefit, po flasim qytetit, por ndërkohë kaq familje sa jemi neve nuk kemi mundësi të kemi të paktën sipërfaqet që aktualisht po lëmë, pra po lejmë 100 m banesë me çmimin që marim neve nuk blejmë dot një gazionere. Thashë kjo është pjesë për fat të keq e informalitetit që shoqëria jonë vazhdon sot e kësaj dite, sepse nëqoftëse çmimet do të ishin deklaru reale unë nuk fus shpirtin ngjynaf që nuk janë bërë të gjithë këto kështu, por fakti që të gjithë dimë që në atë zonë çmimet nuk janë reale 700 – 800 euro m<sup>2</sup> por janë të paktën 2 ose 3-fishi.

Përsa i takon vlerës tokës komisioni është referu flasim për tokën në këtë zonë ASHK-ja ngaqë nuk ka pasur tratativa për token, neve marrin për bazë atë çfarë çmimin referencë i qeverisë, edhe këtu them që ka mundësi të rishikohet, ka mundësi që të rishikohet, sepse OK ne nuk dimë çmimin e referencës, por trajtimi që bëhet i tokës në nivelin që bëhet tokë pronar apo tokë zhvillues ne arrijmë t'i japim vlerë edhe tokës, thashë këto do të jenë procedura, që uroj të mos bëhen pengesë nesër për zhvillimin e këtij projekti, nëqoftëse do të fillojnë të hapin gjyqet, sigurimet e padisë dhe gjëra të tjera mund të ngelim në proces apo mund të ngelim peng i proceseve gjyqsore dhe ajo çfarë është interesi jonë i të gjithëve bashkë këtu është zhvillimi dhe rivitalizimi i kësaj zone, nxjerrja e këtyre objekteve të trashëgimisë kulturore, rivlerësimi i kësaj zone historike e qytetit të Durrësit siç e thashë që në fillim është i vonuar, por më mirë vonë se kurrë. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi:** Duhet të sqaroj diçka thjesht për procedurë përsa i përket të gjithë vlerave të cilat ju parashtruat më lart, besoj që nuk ndikojnë ke procesi, sepse edhe nëse vlera do të ndryshonte në një moment të dytë, thjesht do u detyronte bashkia ose qeveria ta shtonte vlerën ose ta pakësonte, kështu që nuk besoj që prish punë ke ky proces.

**Ardian Muka:** Nga ana ligjore them...

**Ani Dyrmishi:** Në kuptimin procedural thashë nuk është...

Nëse ASHK-ja do ta sjelli vlerën sot 200 ty, apo 100 nuk do të ndryshoj asnjë gjë, thjesht ti do të jesh i detyruar të paguash vlerën që të ka sjellë ASHK-ja apo vlerën që të ka sjellë çmimin e referencës.... Nuk prish punë procesi nuk bllokohet për këtë arsye, sepse vlerat ndryshojnë në referencë edhe në treg.

**Ardian Muka:** Faleminderit.

**Ani Dyrmishi:** Zonja Devolli.

**Edlira Devolli:** Përshëndetje secilit nga ju, ndjesë dhe për cilësinë e zërit se kohë virozash. Pas një diskutimi që kemi pasur dhe në Komisionin e Rregulloreve dhe Çështjeve Juridike, jam dakort që ky projekt që po diskutojmë sot krijon një impakt pozitiv për qytetarët, për komunitetin, për qytetin, turizmin, artin, kulturën, jo vetëm për Durrësin, por në nivel kombëtar.

Për të mos përsëritur dhe ato që tha zoti Muka, le të dalim direkt në interesin financiar të qytetarëve që preken nga ky projekt, shifrat e dëmbshpërblimit apo shpërblimit nuk kanë asnjë lidhje me çmimin aktual të tregut për këtë arsye edhe në komision edhe këtu, e shpreh votën time kundër duke theksuar edhe një herë se jam dakord që qyteti të zhvillohet nga ana arkeologjike, por jam njëkohësisht që pronarët të shpërblehen me vlerën reale të tregut.

Kostatohet dhe diçka tjetër që nga bashkia nuk është programuar asnjë fond për përballje gjyqsore me qytetarët dhe pakënaqësitë e tyre, gjë që është e pashmangshme. Faleminderit.

**Emiriana Sako:** Kryetar, mund të marr fjalën?

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit zonja Devolli.

Po zonja Kryetare.

**Emiriana Sako:** Meqenëse e kërkova, pastaj mund të vazhdosh. Ky në fakt është projekti ose një nga projektet më të rëndësishme që ka pasur ndonjëherë qyteti Durrësit dhe për këtë më vjen mirë që biem dakort së bashku. Sa i takon problematikave që ju prekët lidhur me vlerën e ASHK-së, ne patjetër që kemi marrë të gjitha të dhënat nga ky institucion përsa i takon pronarëve. Megjithatë do të ketë një fazë ankimi, pra ky material pas miratimit këtu do t'i përcillet Agjensisë së Shpronësimit Shtetërore, pra Kombëtare dhe më tej do të vazhdojë procedurat përkatëse ku pas publikimit do të ketë një afat 45 ditor për ankesat apo shqetësimet që mund të kenë qytetarët.

Ne kemi marrë çdo dokument nga ASHK-ja që do të thotë nëqoftëse ju keni një rast që është bërë dëshmia e trashëgimisë dhe nuk është reflektuar këtu, të ftojme ta depozitosh pranë bashkisë ose një ankesë të qytetarit në mënyrë që meqenëse jemi në kohë ta shqyrtojmë në këtë moment.

Preken rreth 99 prona të cilat 40 objekte, 24 janë objekte dhe 35 janë sheshe. Në këtë fazë të parë pas procesit të shpronësimit, i cili ky proces varet nga Bashkia e Durrësit, por ADF-ja do të fillojë punën me kantieret e rikonstruksionit të objekteve dhe këtu në fakt kemi edhe këshilltarë siç e përmendi vetë zoti Muka që preket nga ky investim duke përfituar një ndërhyrje restauruese në objektin e tij dhe kjo është një dëshmi tjetër ku ne i trajtojmë qytetarët të gjithë të barabartë pa dallim cilës forcë politike i përkasin apo çfarëdolloj ngjyrimi tjetër apo diferencimi.

Besojmë që do të kemi shumë shpejt fillimin e kantierit të punës në këtë zonë, ka dhe një projekt tjetër e cila është P2V5 dhe ai është një projekt, i cili ka një ndërhyrje të fortë në qytetin tonë, por atje ende nuk është bërë një projekt i detajuar dhe pikërisht për këtë arsye ne sot kaluam vetëm miratimin e TID-it për ti hapur rrugë investimit, i cili do të vijojë besojmë shumë shpejt dhe mbase do të jetë nevoja që ky vendim të rikalojë në Këshill për të detajuar problematikat apo çështjet që ju përmëndët apo pasaktësi që mund të kenë apo verifikim, sepse aty ka dhe pronar të pavërtetuar në këtë list, pra nëqoftëse të gjithë qytetarët që janë në këtë kategori le të themi, duhet të jenë të aftë të dorëzojnë një dokument pronësie pranë bashkisë ose pranë institucioneve qendrore të shpronësimit sigurisht që do të rishqyrtohet nëpërmjet Këshillit Bashkiak ky proces.

Kaq në vija të përgjithshme pastaj jemi këtu për çdo pyetje që mund të ketë.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Atëherë zoti Vata.

**Samet Vata:** Faleminderit Kryetar!

Fillimisht dëshiroj të bëj me dije se jam pro zhvillimit të qytetit të Durrësit me projektin që është në dobi dhe në shërbim të ridimensionimit të qytetit të Durrësit për vlerën dhe potencialin që ka në aspektin turistik, ekonomik e të tjera me radhë.

Edhe duke mos dash që të përsëritem për çështje të cilat i përmendën paraprakisht kolegët dëshiroj që specifikisht të ngre në bisedim, në diskutim një çështje të cilën e kemi komunikuar e kemi biseduar dhe e cila prek komunitetin myslyman të Shqipërisë respektivisht Myftininë Durrës. Një pjesë ose më saktë dy prona e të cilës shpronësohen përbri murit të vjetër të qytetit të Durrësit. Ajo që dëshiroj që ta ngrej si pyetje dhe si diskutim është fakti që një pjesë e pronësive së komunitetit myslyman dhe Myftinisë Durrës është ai që njihet si kompleksi i Xhamisë së Vjetër dhe i Medresesë së Vajzave që është përbri, dhe duke pasur parasysh që në projektin i cili është paraqitur është një rrugë e cila kalon përbri, pra rruga e cila e pastron të gjithë pjesën që është përbri, brenda murit bizantin prek dy prona të cilat janë ngjitur me Medresenë, pra me institucionin arsimor dhe i kalon mepërmes institucionit të Xhamisë gjë e cila e bën të vështirë fillimisht aktivitetin e përditshëm, të cilët e kanë besimtarët e asaj xhamie dhe në të njëjtën kohë i ngren disa vështirësi disa problematika në menaxhimin e sigurisë së institucionit arsimor. Pra Bashkia a ka menduar ose a ka pasur parasysh se si do të bëhet ose a do të ketë hapësira mundësie për një rrethim ose për mënyrën si do të menaxhohet ajo pjesë duke ditur që në momentin që do të kaloj aty rruga do të bëhet e vëshirë rrethimi duke pasur parasysh që studentët vajzat të cilat janë aty gjatë kohës së pushimeve të ditës në mesin e mësimeve qarkullojnë dhe lëvizin përrreth oborrit aty. Ajo në momentin në të cilin do të bëhet investimi ajo do të bëhet pjesë e qarkullimit të turistëve në mënyrë të vazhdueshme gjë e ciën e bën të vështirë kujdesin dhe sigurinë e tyre aty. Pra nesër, pasnesër a do të jetë e mundur që të bëhet një rrethim ose a do të jetë e mundur të bëhet ndonje investim? Në mënyrë që të jetë fillimisht të jetë siguria e studenteve vajzave domethënë të jetë aty e pasionuar dhe në të njëjtën kohë aktivitetet e përditshme, të cilët i kanë besimtarët e institucionit të jenë të pacënuar dhe të kryhen në formën më të mirë. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit, zoti Vata.

**Emiriana Sako:** Normalisht projekti në moment që është hartuar ka pasur si objektiv kryesor aksesin dhe lirim të hapsirave për të nxjerrë në pah muret bizantine të qytetit. Normalisht është bërë një projekt i detajuar nga një grup arkitektësh, por duke pasur dhe arkeologët në kompozim të këtij grupi le të themi dhe çdo vendimmarrje është marrë teknike. Nëqoftëse ju keni një propozim konkret se si e mendoni ndërhyrjen apo ruajtjen për çështjen e sigurisë jeni të lutur ta dërgoni pranë bashkisë dhe ne të kemi mundësinë të bëjmë një bisedë me ta për shqetësimin që ju ngritët.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Atëhere koment tjetër?

Po zoti Burgija

**Dritan Burgija:** Përshëndetje të gjithëve.

Në fakt e kisha në respekt të komunitetit myslyman e kisha edhe unë këtë pikë që sapo ezauroi kolegu. Në fakt detajet dhe përgjigjen për detajen e dha përgjigjen kryetarja. Po ata ndërkohë që ne ishim në sallë unë u njoha me problemin me një mesazh nga myftiu i Durrësit dhe kanë tentuar të kenë takim me ju për këtë çështje, për të qenë të qartë me problematikat, se janë të paqartë se çfarë do të ndodhi dhe e kanë pasur të pamundur, nuk kanë marrë përgjigje. Për pjesën unë mund të shtjelloja dhe detaje që ato më kanë parashtruar me mesazh gjithsesi e ezauroi kolegu.

Shpesh herë këtu kolegët socialist na kundërvehen dhe në reteorikën e tyre kanë intersin, domëthenë përmendin shpesh interesin për qytetarin, kanë vëmendje vetëm qytetarin dhe janë këtu vetëm për qytetarin në fakt kjo pika 6 ju nxjerr juve, qoftë Qeverinë, qoftë Bashkinë e Durrësit ju nxjerr shumë zbuluar “lakuriq” nëqoftëse doni se ashtu siç keni qef, sepse vetëm qytetarin nuk keni pasur në vëmendje kur keni përcaktu. Ai grupi i punës prej 6 vetash përcakton fatin e 113 familjeve dhe fatin e përcakton mbi bazën e një shkëmbimi email-esh me ASHK-në.

**Emiriana Sako:** Në bazë të ligjit.

**Dritan Burgija :** Bashkia socialiste me drejtimin e ASHK-së socialiste vendosin vlerën e pronave të këtyre njerëzve që në fakt banojnë sot në një zonë elitare, zona më e mirë e Durrësit, zona më e paguar e Durrësit, zoti Muka e preku, i preku çështjet teknike, përmendi edhe çmimet sesa shitet realisht një pronë në këto zona, preku dhe problematikën që ndërkohë që këta prishen 50 m më andej ndërtohet dhe duke qenë se ndërtohet ky grupi i punës e ka pasur shumë të mirë, shumë të kollajt me investigu tregun dhe meqenëse kemi te bëjmë me 113 familje që konsiderohen autoktone durrsake, mbiemra durrsak që mund ta kemi për nder t’i përmendim mbiemrat, të kishim qenë më të drejtë me to mos t’i futemi në xhep në këtë formë.

Më keq akoma, kur ka familje të njëjta që para dy vjetësh janë vlerësuar me vlera të tjera, vlera më të larta në fletoren zyrtare që janë publikuar me emra, familja Bërdaku po marrë një, është vlerësuar për vlerën e pronës për metra katror 900, afër 1000000 lekë të vjetra, sot në vendimet tuaja domethënë atyre i ulët ajo vlerë i shkon rreth 800000 lekë të vjetra, po flas me të vjetra që ta kuptojnë të gjithë qytetarët. Tani, ne si këshilltarë këtu a ka ndonjë që të thotë që në këto vite Durrësit i janë ulur vlerat e pronave vlerat e pasurisë apo i janë rritur? Për me qenë të drejtë edhe të flasim ashtu siç duhet në favor të këtyre qytetarëve. Para, në fletoren zyrtare të 2022 janë bërë 12 apo 13 shpronësime dhe janë bërë me 1000000 lekë të vjetra për m<sup>2</sup> sot pas disa vitesh vi këtu edhe nuk është tallje, se nëqoftëse do të them tallemi, do të tregohem shumë i moderuar po i vjedhim ato qytetarë.

**Ani Dyrmishi :** Kush po i vjedh ?

**Dritan Burgija:** Shteti po i vjedh.

**Ani Dyrmishi:** Nga i merr çmimet qytetari, ti nuk i ke informacionet e duhura që nga i merr çmimet.

**Dritan Burgija:** Jo informacionin e duhur .....

**Ani Dyrmishi:** Se çmimet vinë nga kontratat e ngjashme gjatë gjithë periudhës 3 mujore. Qytetari ka bërë kontratat që ti e di shumë mirë, nëqoftëse don të disinformosh...

**Burgija:** Zoti Kyetar ta mbaroj unë....

**Ani Dyrmishi:** E pra, ky është disinformim ....

**Dritan Burgija:** Nuk është disinformim.

**Ani Dyrmishi:** Çmimi vjen nga kontratat e tregut, nëqoftëse ti ke ndonjë rast që ka abuzuar me vlerën e çmimit mund ta denancosh në prokurori.....

**Dritan Burgija:** Fola për drejtimin e ASHK-së nga Partia Socialiste, fola edhe për bashkinë që drejtohet...

**Ani Dyrmishi:** Nuk ka lidhje....

**Dritan Burgija:** Po pra, po po , por është detyra juaj ta luftoni informalitetin .....

**Ani Dyrmishi:** Ne s'kemi rast...  
S'ka lidhje me ASHK-në kjo.

**Dritan Burgija:** Është detyra juaj të luftoni informalitetin.  
Nuk është, tashi nuk e di, e ke për përgjigje për të kamuflu që mos të më lesh të mbaroj fjalën apo .....

**Ani Dyrmishi:** Jo pra, po ju po thoni e keni caktuar çmimin ju, nuk e kemi caktuar ne çmimin.  
Çmimi vjen nga një procedurë, që ti nuk e ke informacion.

**Dritan Burgija :** Tashi nuk po përsëris më, çfarë thashë aty rekordet janë.

**Ani Dyrmishi:** Kjo është e vërteta...

**Dritan Burgija:** Rekordet janë merrni transkriptojini dhe do e kuptoni se çfarë po them ...

**Ani Dyrmishi:** Kjo është e vërteta...

**Dritan Burgija :** Para dy vjetësh keni shpronësuar njerëzit me 1000000 lekë m<sup>2</sup>, sot vini këtu dhe doni t'i shpronësoni këto njerëz me 800000 lekë m<sup>2</sup>, pyetja është : Vlera e tregut është rritur në



Durrës apo është ulur? Si mund të talllemi se e thashë një herë fjala tallje sot më duket shumë e moderume.

Pastaj pika tjetër, keni planifikuar aty prishje shtëpiash dhe lënie hapësirave të gjelbëra pasi e betonizuat këtë Durrës, s' du të përdor nai term tjetër që nuk i shkon kësaj salle, po prishni shëpiat, po nxirrni njerëzit nga shtëpiat për të bërë lulishte, ju qofshi, ju qofshi që flisni këtu edhe në emër të qytetarëve. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Koment tjetër?

**Llesh Çuni:** Kam unë.

**Ani Dyrmishi:** Po, zoti Çuni.

**Llesh Çuni:** Kolegu parafolës ka të gjithë të drejtën e zotit t'i politizojë të gjitha projektvendimet që vijnë këtu në Këshillin e bashkisë, por të fyej kolegët e vet, e të thotë që për pikën 6, juve ju djeg shpirti për popullin, por në këtë rast dolët zbuluar, dolët "lakuriq" ashtu siç e keni qef ju. Kjo është e pafalshme një herë të dalë nga goja e një këshilltari si shprehje, prandaj unë kërkoj ta tërheqësh shprehjen, nëse e kanë përdorur të tjerë s'ka pse e ve ai në gojën e tij dhe aq më tepër për të gjithë kolegët e nderuar që janë në këtë sallë.  
Faleminderit.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Atëherë koment tjetër në lidhje me pikën?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është Pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës?

25 pro.

Kundra? .... 7

Abstenim? .....6

25 pro, 7 kundra, 6 abstenim, atëhere miratohet pika 6 e rendit të ditës.

(4 këshilltarë në sallë nuk votuan)

- Kalojmë **në pikën 7**. I jepet fjala Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike zotit Rakipi.

**Dritan Rakipi:** Komisioni u mbledh për të shqyrtuar "Programin e punës së Këshillit Bashkiak Durrës për periudhën janar-dhjetor 2025". Komisioni i Rregulloreve dhe Çështjeve Juridike në mënyrë unanime votoi për ta kaluar për votim.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit zoti Rakipi.

Në lidhje me pikën 7 kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës?

Kundra?... S'ka

Abstenim? .....S'ka

Atëhere 41 vota pro, se 2 këshilltarë u larguan, miratohet dhe pika 7 e rendit të ditës.

- Kanë kërkuar fjalën **për diskutim** zonja Devolli, përgatitet Anisa Ibraj dhe pastaj Zhuljeta Ngoti.

**Edlira Devolli:** Faleminderit kryetar.

Diskutimi im mbetet ai i mbledhjes së shkuar, për pallatin e ndërtuar në lagjen 17, rruga Ahmet Dakli dhe rruga Lura. Banorëve u janë dhënë çelësat, kanë mobiluar shtëpitë dhe vazhdojnë të jetojnë me qera, sepse i mungon uji dhe energjia, theksoj këtu jetojnë me qera pa i marrë bonuset. A ka ndonjë haber të ri për këtë komunitet, a ka ndonjë ...

**Flutura Kasa:** Afroje i çik atë.

**Edlira Devolli:** Po, por besoj se u dëgjova.

A ka ndonjë informacion, ndonjë haber të ri për këtë komunitet? Faleminderit.

**Emiriana Sako:** Do t'i marojmë të gjitha pyetjet dhe të përgjigjem apo një për një?

**Edlira Devolli:** Jo vetëm kaq, vetëm këtë kisha.

**Ani Dyrmishi:** Zonja Ibraj vazhdo që t'i mbarojmë pyetjet të gjitha dhe pastaj përgjigjet kryetarja një për një.

**Anisa Ibraj:** Përshëndetje të gjithëve.

Atëhere unë kam rastin që e kam përmendur dhe para dy mbledhjeve për transportin e nxënësve të shkollës 9 vjeçare Shefqet Ndroqi, duke qenë se prindërit janë akoma të shqetësuar.

Atëherë pyetjet e mia janë : A kemi një përgjigje nga Vendimi i Këshillit të Ministrave për ndryshimin e distancës së kilometrave? A janë marrë masa për rimbursimin e prindërve dhe sa do të zgjasi gjithë procesi?

Gjithashtu kam edhe kërkesën tjetër për situatën e 135 familjeve që akoma nuk janë futur në shtëpitë e ndërtuara nga tërmeti pamvarësisht që ka kaluar rreth 5 muaj që nga dorëzimi i çelsave të apartamentëve të ndërtuara në kuadër të procesit të rindërtimit. Banorët ende nuk janë strehuar në banesat kolektive nr.1 dhe 3, rruga Duras dhe nr.15 dhe 23 rruga Ahmet Dakli.

Faleminderit.

**Ani Dyrmishi:** Zonja Ngota.

**Zhuljeta Ngoti :** Atëhere dhe një herë përshëndetje.

Unë kam disa pyetje në fakt, janë aktualitete. Po e nis me lagjien 13, ku jam dhe vetë banore e asaj lagjeje, e meqenëse jemi në prag festash përjashtuar bizneseve private, të cilët kanë dhënë ngjyra festive nuk kam vënë re asgjë nga bashkia domethënë në lidhje me atmosferat festive dhe

nuk e kuptoj pse është kjo indeferentizëm ndaj zonës plazhit, ndërkohë që plazhi është burim i të ardhurave, është ajo që e bën qytetin qytet turistik domethënë nuk e kuptoj asnjëlloj banderole në lidhje me festat sipas simboleve, asnjë flamur për festat e nëntorit, asnjë dritë për...

**Ani Dyrmishi:** Po po bëhen rrugës janë...

**Zhuljeta Ngoti:** Ndoshta është dhe për të qeshur por nuk e di domethënë më duket sikur...

**Ani Dyrmishi:** I ke rrugët po bëhen...

**Zhuljeta Ngoti:** Urdhëro?

**Ani Dyrmishi:** Ideja është që ato kanë një fillim, ka dhe një, varet se si është pjesa e zbukurimeve.

**Zhuljeta Ngoti:** Unë kam prej vitesh prej vitesh që nuk e shikoj këtë zoti kryetar, prej vitesh nuk e shikoj këtë....

Jo realisht ndoshta është për të qeshur nuk e di, por...

**Ani Dyrmishi:** Është për tu bërë, nuk është për të qesh, është duke u bërë .

**Zhuljeta Ngota:** OK

**Ani Dyrmishi:** Unë thashë në kuptimin pozitiv, jo negativ.

**Zhuljeta Ngota:** Faleminderit shumë, ideja është që duket sikur kalon në një vend tjetër... duket sikur...

**Ani Dyrmishi:** Jo, jo me të vërtetë janë duke u bërë rrugët, por varet se ku fillon. Se ti e ke parë këtu është zbukuruar.

**Zhuljeta Ngota:** Po kuptoj po disa drita i kishit lënë mangët këtu dhe të vendosen nga Ura e Dajlanit dhe deri në Plepa.

**Ani Dyrmishi:** Nuk janë mangët, janë të gjitha dritat, thjesht janë duke ardhur.

**Zhuljeta Ngota:** Për vitin tjetër?

Jo kjo është faktikisht, unë jam banore aty që në vitin 2000 dhe nuk kam vënë re faktikisht asnjë herë një zbukurim të plazhit që të jemi realist. Ok faleminderit, faleminderit.

Edhe përse i përket numrit të plazhit ju e dini që është një numër i konsiderueshëm dhe nuk është nevoja të jua them statistikën, sepse referuar profilit domethënë është një numër prej 87298 banorë, futur këtu lagjjen 13, 14 dhe 17.

Ok atëhere, tek sheshi i kompleksit Kasa ku unë jam banore edhe vetë aty është bërë një restaurim nga bashkia edhe në fakt aty përveçse është vënë një beton nuk është që është bërë një gjë, asgjë nuk është bërë në shërbim të banorëve pasi është sistemuar ...

**Emiriana Sako:** Si s'është bërë, është sistemuar parkimi, është bërë territori sportive që të lozin fëmijët, është bërë reabilitimi i shkollës që ishte parkonin deri te dera brenda shkollës... Janë bërë kanalizime, janë mbjellë pemë, nuk e di çfarë duhet të bëhet më tepër domethënë....

**Zhuljeta Ngoti:** Po kuptoj, por nuk e di sesa i keni djekur këto dhe kush i ka ndjekur në fakt këto punime.

**Emiriana Sako:** Mbikqyrësit, mbikqyrësit.

**Zhuljeta Ngoti:** Sepse akoma pa mbaruar punimet aty është hapur asfalti dhe është bërë një gropë po ta vini re aty është....

**Emiriana Sako:** Po, do ta verifikojmë këtë shqetësim.

**Zhuljeta Ngoti:** Vetëm punime që s'janë ato, unë nuk e di kush i ka ndjekur ato. Përsa i përket kësaj dhe një ditë kur ra tabela e basketbollit për pak sa nuk zuri një fëmijë aty dhe akoma ajo është në vënd, domethënë. Ajo çfarë i duhet asaj, zone zonja Kryetare është që të ketë një port siç ka qenë fillimisht.

**Emiriana Sako:** Ku port në rrugë?

**Zhuljeta Ngoti:** Një port tek shkolla ku futesh në kompleks tek shkolla Bajram Curri. Aty ka qenë një tip trau që ne nuk e kemi, unë personalisht unë jam banore aty dhe unë kam 2 vite që nuk parkoj makinën time aty, sepse aty është bërë si zonë që vijnë të gjithë kush ka nevojë, vijnë dhe është bërë si parking i lagjes Hekurudha, sepse ne nuk kemi, nuk administrojmë dot zonën tonë që ne kemi dhënë miliona aty për të ndejt aty dhe unë s'kam një vend parkingu fjala që vjen, dhe ky është fakt ee. Përse ndodh kjo? Sepse gjithë hyrja e nxënësve është bërë në hyrjen nga sa i përket pjesës hapsirës sonë, ndërkohë që hyrja e shkollës Abedin Dino, ka qenë në lindje nuk e di pse prej disa vitesh kjo është kthyer këtej dhe e gjithë kjo bën një kolaps dhe shpesh herë ngelim edhe vonë për të shkuar në punë ma beso, sepse bëhet një trafik, bëhet një kaos aty që nuk e di domethënë .

Edhe përsa i përket pastaj është zona lagjja, rruga Eqerem Çabej, nuk e di pse si vihet dorë asaj lagjje dhe shpesh herë unë hasem me banorët aty dhe madje madje ato kanë marrë dhe një vendim që të bëjnë një formë proteste për këtë, nuk e di. Nuk e di aty shkohet premtohet vazhdimisht dhe asnjëherë nuk është, dhe mjafton dy pika shi të bie aty dhe përmytesh, bëhen pellgjet është gropa, nuk e di kush mund t'i observojë këto, por që është në mjerim të fatit. Pastaj përpos kësaj është dhe një lagjje aty janë 200 m rrugë tek rrota e kuqe tek pallati 10 katësh pallati Bealb dhe një

kolegu im që është edhe mjek aty thotë që, nuk e prek njeri këtë zonë pasi ne na njohin si zonë demokrate, kjo nuk bën sens.

**Emiriana Sako:** Po ja ke këshilltarin që do përfitoj nga investimi çfarë lidhje ka këtu?

**Zhuljeta Ngota:** OK nëqoftëse kjo është në shërbim të ...

**Emiriana Sako:** Jo ne se kemi pasur asnjëherë atë ndasinë që ju e përmendni gjithmonë, nuk e di pse akoma pas kaq shumë dekadash, akoma shifet kjo gjë e prerë kështu me thikë nga ana juaj, sepse edhe kur shtohet rruga se kalon demokraci, se kalon socialisti nuk i mat njeri dhe to shikojë domethënë nuk ....

**Zhuljeta Ngota:** Është zëri i qytetarit këtu.

**Emiriana Sako:** Po patjetër

**Zhuljeta Ngota:** Thjesht ishte zëri i qytetarit që, i qytetarëve...

**Emiriana Sako:** Dhe pikërisht për këtë arsye them që me ë vërtetë rruga mund të jetë e pashtuar, por nuk mund ta etiketojmë rrugë demokratësh, është qerashake kjo.

**Zhuljeta Ngota:** Mundet që të jua ballafaqoj këtë sepse kështu ma thanë...

**Emiriana Sako:** Në optikën time është qesharake domethënë...

**Zhuljeta Ngota:** Ok edhe mund të jetë...

**Emiriana Sako:** Sigurisht që mund ta thonë, po ju jeni në Këshill, unë do tërhiqesha për ta thënë këtë fjali, megjithatë rruga Eqerem Çabej është futur në paketën që ne kemi me Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe mund të fillojë për një muaj atje, domethënë kemi 40 rrugë atje, të cilat do të fillojnë të gjitha dhe mund, brenda besoj dhjetorit do të kemi fillimin e zbatimit të kësaj kontrate dhe sigurisht që kjo rrugë mund të bëhet për një muaj, mund të bëhet për dy javë, mund të fillojë për dy muaj, pak rëndësi ka se duke qenë 40 rrugë ka një efekt shtrirje në kohë ky projekt domethënë. Rruga tek rrota e kuqe që ju thoni e demokratëve që s'është shtruar, rruga e demokratëve...

**Zhuljeta Ngota:** Jo kështu ma referuan unë nuk e njoh atë, unë vetëm shkova e pash edhe...

**Emiriana Sako:** .... duhet të ketë një emër rruge besoj, na e sillni dhe atë ta shikojmë t'ja shtrojmë demokratëve aty meqenëse.

**Zhuljeta Ngota:** Ok shumë mirë do bëni...Po pse mos ta vendosim rruga e demokratëve do të ishte bukur.....

**Emiriana Sako:** Nuk e di a do ta pranojnë banorët, se ju mund ta sillni propozimin, duhet ta pranojnë banorët duhet të jenë banorët dakort.

**Zhuljeta Ngota:** Tani po i japim pak ngjyra humori po...

**Emiriana Sako:** Pastaj sheshi tek shkolla “Kasa” ka qenë në një gjendje tejet të amortizuar një problematik shumë të gjatë, jo që s’ka dash bashkia të investojë atje, por se ajo ka qenë një pronë private dhe ne kemi marrë dakortësinë e pronarit, i cili ka zhvilluar ato pallatet para 10 apo 20 vitesh kur i ka zhvilluar që kemi bërë investimin atje dhe sigurisht që pyetjet pse s’kemi parkim brenda pallatit duhet të ja bëni atij jo bashkisë . Bashkia ka një program....

**Zhuljeta Ngota:** Ne e kemi një parkim, por vijnë të tjerët parkojnë aty sepse është një zonë pa port.

**Emiriana Sako:** Tra, të mbyllim të gjitha rrugët e lagjet e Durrësit me tra, kjo nuk është normale dhe s’ka për të ndodh , kështu që dhe shkolla e ka hapur derën nga aksesit që ka më afër me rrugën pasi është ndërtuar para 8 ose 9 vitesh është ndërtuar shkollë e re, është bërë aksesit me idenë e bashkimit të të dyjave shkollave në një territor të përbashkët të Bajram Currit dhe të shkollës nga pas, kjo ka qenë ideja domethënë pse është bërë dalja këtej.

**Zhuljeta Ngota:** Mundem .

**Emiriana Sako:** Po.

**Zhuljeta Ngota:** Tek lagja e Tabakëve është shtruar dhe te kompleksi Kasa ato kanë një port hekuri që e kanë vën vet qytetarët....

**Emiriana Sako :** Po jap përgjigjen për dy pyetjet e tjera sepse bashkë e ezauruam.

Lura me Ahmet Dakli është dorëzuar nga Bashkia Durrësit pasi Fondi Shqiptar mbaroi pjesën e investimit dorëzuar çelësat banorëve, sepse normalisht koha e arredimit dhe e mobilimit të banesave do të marrin kohën e caktuar. Aktualisht atje është duke punuar OSHE për lidhjen me rrjetin furnizimin me rrjetin, ashtu ujësjellsit, të cilët janë dy institucione që kanë planin e vet të punës, buxhetet e veta, normalisht besojmë që, qytetarët kanë ardhur në bashki e kanë shprehur këtë shqetësim që nuk është bërë lidhja e të tjera me radhë, i kemi adresuar besojmë se do të jetë një proces që do të mbroj shumë shpejt .

Shkolla Shefqet Ndroqi dhe për disa shkolla të tjera që kemi pas problematikën e nxënësve VKM nuk ka dalë akoma, por ZVA ka bërë një ndërveprim me shkollat dhe me bashkinë për punën e distancave dhe ividentimin e atyre banorëve, të atyre familjeve dhe fëmijëve, të cilët bëjnë rrugët dhe kanë nevojë për mbështetje financiare dhe sot që flasim ato janë dorëzuar në ministri për të

marrë aprovimin për të bërë pagesën.VKM-ja s'ka dal akoma, në moment që do dali do të jetë publike për të gjithë nuk do na çohet ne apo këshillit si informacion, por do marrin djeni të gjitha instituconet përkatëse. Shumë faleminderit.

**Anisa Ibraj:** Pra në momentin që do dali VKM-ja do rimbursohen.

**Emiriana Sako:** Jo përpara, tani janë në ministri. Ne kemi çuar distancat dhe familjet, të cilat nga shkollat na kanë ardhur që kanë këtë shqeesim, pra shkolla, kjo shkollë ka thënë që kam 20-30 familje që kanë këtë shqetësim, këto i kemi listuar bashkë me distancat e i kemi çuar në ministri që t'ja raportojmë që këto nxënës kanë shqetësimin e ngritur dhe ndërkohë paralel ka nisur procedura për daljen apo ndryshimin e VKM-së, e cila nuk është kompetencë e Bashkisë është kometencë e Qeverisë.

**Anisa Ibraj:** Pra, bashkia do marrë masa që të rimbursohen këto familje.

**Emiriana Sako:** Po pra këtë po them, i kemi çuar listat në ministri, i ka çuar ZVA se dhe kjo nuk është funksioni i bashkisë gjithësesi.

**Anisa Ibraj:** Po, për pyetjen e dytë për familjet që kanë marrë....?

**Emirina Sako:** E ktheva përgjigjen.

**Anisa Ibraj :** Thuaje dhe një herë

**Emiriana Sako:** Po pse ta them dhe njëherë, e thashë dëgjoje kur e them unë e shpjegova sapo e mbarova kështu që nuk e them dhe një herë se besoj që duhet ta kesh mendjen këtu kur flasim domëthënë.

**Anisa Ibraj:** Por, përsërite e ke për detyrë.

**Emiriana Sako:** Po jo nuk e përsëris unë, se ti e ke për detyrë, ti bën pyetjen e s'dëgjon përgjigjen ca të them unë ty tani....

**Anisa Ibraj :** Ata kanë ardhur dhe për t'ju takuar.

**Emiriana Sako:** Patjetër që i kam dëgjuar, i kam takuar, patjetër, patjetër....

**Ani Dyrmishi :** Anisa, të lutem.

**Anisa Ibraj:** Po bën figurë të keqe këtu së nuk po më injoron mua, po injoron qytetarin.

**Emiriana Sako:** Jo jo në fakt po bën ti figurë të keqe këtu, se unë sapo e dhashë përgjigjen.

Po pyet kolegët që bënë të njëjtën pyetje, pyet nënkryetaren që bëri të njëjtën pyetje e dhashë përgjigjen apo jo.... Që ta verifikosh se.....

**Ani Dyrmishi:** Atëherë faleminderit Kryetare.  
Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

*Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 24 (njëzet e katër) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.*

**Mbajtësi i procesverbalit:** Enxhi Gjuzi

**Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :**

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Zëvendëskryetar i Këshillit :

DENISA LUARASI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

EDLIRA DEVOLLI

Kryetar i Gr. Partisë Lirisë :

KONTJANA KUÇI